

Njoftim për zhvillimin e konsultimit publik me grupet e interesit, lidhur me projektligjin “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital”

Qëllimi i projektligjit “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital” është vendosja e një kuadri ligjor të qartë dhe të unifikuar për identifikimin elektronik të sigurt, ofrimin e shërbimeve të besuara si dhe ndërtimin dhe funksionimin e portofolit të identitetit digjital, duke garantuar siguri, integritet, ndërveprueshmëri si dhe besueshmëri në transaksionet elektronike si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat.

Projektligji vendos përcaktime të qarta lidhur me nënshkrimin elektronik, vulat elektronike, vulat kohore elektronike, shërbimin elektronik të regjistruar të transmetimit, autentifikimin e faqeve të internetit, arkivimin elektronik dhe vërtetimin elektronik të attributeve, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të vulës elektronike dhe regjistrat elektronikë në Republikën Shqipërisë si dhe vendos një bazë solide për ndërtimin dhe funksionimin e identitetit digjital në përputhje me standardet evropiane.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- krijimi një kuadri ligjor të plotë dhe të unifikuar për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, njohjen reciproke dhe ndërveprueshmërinë e tyre;
- rritja e sigurisë për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, duke siguruar një bazë të përbashkët për bashkëveprim të sigurt elektronik midis qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin, integritetin, sigurinë dhe besueshmërinë në ofrimin e shërbimeve të besuara në Republikën e Shqipërisë;
- ndërtimi dhe funksionimi i Portofolit të Identitetit Digjital si mjet i qëndrueshëm dhe i besueshëm për menaxhimin e identitetit digjital;
- përafrimi i kuadrit ligjor për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara me acquis e BE , rregulloren eIDAS1 dhe eIDAS2( Rregulloren (BE) nr.910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe që shfuqizon direktivën 1999/93/KE”, Numri CELEX 32014R0910, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. L257, datë 28.8.2014, faqe 73-114” dhe Rregulloren nr. 2024/1183 të

Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Prill 2024, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 lidhur me krijimin e Identitetit Digjital Evropian , Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, 2024/1183 datë 30.04.2024, faqe 73-114”), duke përmbushur një nga kushtet thelbësore për përafrimin e Shqipërisë me *acquis communautaire* në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara si pjesë e procesit të integritit evropian.

Palët e interesuara janë të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektligjin, brenda 20 ditëve pune nga data e shpalljes së këtij njoftimi, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: [anxhela.brahimi@aksk.gov.al](mailto:anxhela.brahimi@aksk.gov.al)

Gjithashtu, në datat 26 dhe 27 Qershor, Autoriteti do të organizojë takime konsultative me grupet e interesit që preken nga ky projektligj, ku do të prezantohen risitë e këtij projektligji dhe do të ftohen grupet e interesuara të japin komente dhe sugjerimet e tyre.

Projektligji “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital” si dhe relacioni përkatës gjendet në linkun e mëposhtëm:

1. Projektligji “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital”
2. Relacioni i projektligjit.